

Analiza e Qeverisjes së Hapur të Ministrisë së Arsimit,
Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË KOSOVË

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument u zhvillua si pjesë e projektit 'Përmirësimi i Qeverisjes së Mirë 4.0', i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED), dhe i implementuar nga Open Data Kosovo (ODK).

AUTORËT

Dafina Olluri dhe Delvina Haxhijaha

VERSIONET GJUHËSORE

SHQ, ANG, SER

Përfunduar në dhjetor 2023 © ODK

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jofitimprurëse janë të autorizuara, me kusht që të dihet burimi dhe publikuesi të njoftohet paraprakisht dhe të dërgohet një kopje.

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

Hyrje	1
Metodologjia e Hulumtimit	2
QASJA	3
NDËRGJEGJSIMI	5
INTEGRITETI	5
TRANSPARENCA	6
ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË AKTIVITETET E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	8
REKOMANDIMET	9

HYRJE

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) luan një rol kyç në formësimin e peizazhit arsimor, shkencor, teknologjik dhe inovativ të Kosovës. Si institucion i nivelit qendror përgjegjës për këta sektorë kritikë, politikat, vendimet dhe veprimet e MASHTI-t kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, cilësinë e arsimit, avancimin e kërkimit shkencor dhe ekosistemin e inovacionit. Në një shoqëri demokratike, transparencë dhe hapja në funksionimin e institucioneve qeveritare janë thelbësore për llogaridhënie, ndërtim të besimit dhe qeverisje efektive. Monitorimi i punës së MASHTI-t është thelbësor për t'u siguruar që ai funksionon me integritet, ndjek standardet ligjore dhe etike dhe i shërben interesave më të mira të qytetarëve dhe kombit në tërësi.

Duke vlerësuar nivelin e hapjes dhe transparencës brenda MASHTI-t, palët e interesit mund të fitojnë njohuri mbi proceset e saj vendimmarrës, shpërndarjen e burimeve, formulimin e politikave dhe strategjitë e zbatimit. Ky informacion është i çmueshëm për politikëbërësit, edukatorët, hulumtuesit, inovatorët dhe publikun për të kuptuar se si funksionon MASHTI, si ndikon në jetën e tyre dhe si mund të përmirësohet për t'iu shërbyer më mirë nevojave të shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës.

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë gjetjet e Indeksit të Hapjes të realizuar për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë për vitin 2022, duke vlerësuar nivelin e transparencës së institucionit. Indeksi i Hapjes Rajonale i realizuar për MASHTI-n ofron një kornizë gjithëpërfshirës për vlerësimin e hapjes dhe transparencës së ministrisë. Rezultatet e këtij vlerësimi mund të shërbejnë si bazë për diskutime të informuara, avokim të bazuar në prova dhe ndërhyrje të synuara që synojnë përmirësimin e performancës së MASHTI-t, nxitjen e kulturës së transparencës dhe promovimin e praktikave të mira të qeverisjes në sektorët e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit të Kosovës.

Si përmbledhje, monitorimi i punës së MASHTI-t është thelbësor për promovimin e llogaridhënies, sigurimin e qeverisjes së mirë dhe avancimin e synimeve zhvillimore të Kosovës. Transparenca në veprimtarinë e MASHTI-t nuk është vetëm një parim demokratik, por edhe një domosdoshmëri praktike për ndërtimin e një shoqërie të begatë dhe gjithëpërfshirëse të bazuar në njohuri, inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm. ODK ka respektuar parimet e transparencës së hulumtimit dhe të gjitha detajet dhe rezultatet e saj ia ka paraqitur institucionit të vlerësuar. ODK mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim në lidhje me këtë dokument të politikave.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Analiza është bazuar në katër parime udhëzuese që kanë vlerësuar përdorimin e të dhënave nga Indeksi i Hapjes Rajonale në lidhje me MASHTI-n, një mjet që vlerëson qasjen e institucioneve qeveritare për publikun dhe shoqërinë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Konkretisht, për MASHTI-n, parimet e vlerësuara ishin transparenca, qasja, integriteti dhe ndërgjegjësimi.

Këto janë vlerësuar në bazë të kriterëve siç janë lehtësia e qasjes në informacion në faqet zyrtare të internetit të institucionit, cilësia e strukturës ligjor për temat përkatëse, burimet shitesë të informacionit publik dhe pyetësorët e dorëzuar nga institucioni. Një model i verifikimit të të dhënave është përdorur pas mbledhjes së të dhënave, duke çuar në një gabim standard prej +/- 3%. Vlerësimi u zhvillua nga qershori i vitit 2023 deri në fund të nëntorit të vitit 2023, duke rezultuar në një sërë rekomandimesh për institucionet bazuar në gjetjet e hulumtimit.

Transparenca kërkon qasjen e publikut në të dhënat organizative, buxhetet dhe proceset e prokurimit publik. Qasja përfshin krijimin dhe mbështetjen e politikave për qasje të pakufizuar në informacion, rritjen e qasjes përmes diskutimeve publike dhe nxitjen e angazhimit të qytetarëve. Integriteti përfshin aspektet siç janë lobimi, respektimi i kodit të etikës dhe luftimi i korrupsionit. Së fundmi, ndërgjegjësimi fokusohet në vëzhgimin dhe vlerësimin e politikave të zbatuara institucionalisht. Të katër parimet, pjesë përbërëse e Indeksit të Hapjes Rajonale, kontribuojnë në përcaktimin, prezantimin dhe vlerësimin e punës dhe demonstrimin e vullnetit politik drejt transparencës.

QASJA

Në kontekstin e MASHTI-t, parimi i qasjes është thelbësor për të siguruar që ministria të angazhohet në mënyrë aktive me publikun dhe palët e interesit në një mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Kjo përfshin bërjen e informacionit lehtësisht të qasshëm për publikun, kërkimin e komenteve përmes konsultimit publik për programet dhe iniciativat arsimore dhe nxitjen e dialogut kuptimplotë me qytetarët për të siguruar që aktivitetet e MASHTI-t të përputhen me nevojat e komunitetit. Për këtë vit, vlerësimi i MASHTI-it ka arritur rezultatin prej 68% në këtë parim.

Ndryshe nga vlerësimi për vitin 2021, anketa e vitit 2022 e zyrtarëve të MASHTI-t nxori në pah ekzistencën e një mekanizmi trajnimi apo udhëzimi. Ky mekanizëm, i ofruar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, u mundëson nëpunësve publikë të vlerësojnë materialet, të dhënat dhe informacionet e tjera për shpalesje publike dhe të përmbushin detyrimet e tyre sipas Aktit për Lel (Akti i së Drejtës për Informim). Ky zhvillim shënon një ndryshim pozitiv nga mungesa e një mekanizmi të tillë në vitin 2021, duke treguar progres në rritjen e transparencës dhe pajtueshmërisë brenda MASHTI-it.

Qasje në informacion, e referuar gjithashtu si e drejta për informim ose liria e informacionit, është një element themelor i qeverisjes së hapur. Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, çdo institucion publik duhet të caktojë një individ përgjegjës për të procesuar rregullisht kërkesat e pranuar dhe për të krijuar një adresë elektronike zyrtare ekskluzivisht për komunikim publik. Ky ligj zbatohet duke siguruar që një person i caktuar trajton kërkesat për lirinë e informacionit menjëherë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Gjetjet nga anketa e kryer me zyrtarë të MASHTI-t në vitin 2022 tregojnë progres në përpjekjet e institucionit për të lehtësuar komunikimin me publikun në lidhje me qasjen në informacion. Me 47 nga 48 kërkesa për qasje të lirë në informacion të pranuar dhe për të cilat është kthyer përgjigje, ka një trend pozitiv drejt përgjegjshmërisë dhe transparencës brenda MASHTI-t. Megjithatë, refuzimi i një kërkesë për shkak të mungesës së përgjigjes nga zyra e adresuar nxjerr në pah nevojën për vigjilencë të vazhdueshme për të siguruar që të gjitha kërkesat të procesohen në mënyrë efektive.

MASHTI duhet të ruajë këtë momentum dhe të përmirësojë më tej mekanizmat e tij për trajtimin e kërkesave, duke përforcuar kështu angazhimin e tij për parimet e qeverisë së hapur dhe duke përmirësuar besimin dhe angazhimin e publikut.

Në anketën e bërë me zyrtarë të MASHTI-t, është kuptuar se janë organizuar konsultime publike për tri projektligje: Projektligjin për Arsimin në Fëmijëri të Hershme, Projektligjin për Tekstet Shkollore dhe Projektligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Për më tepër, të dhënat dhe dokumentet e mbledhura nga këto konsultime publike janë vënë në dispozicion të publikut, duke demonstruar një përkushtim për transparencë në procesin legjislativ.

Për më tepër, raportet dhe vlerësimet që rrjedhin nga këto konsultime publike janë publikuar gjithashtu, duke treguar një përpjekje për të ofruar informacion të plotë në lidhje me rezultatet dhe komentet e marra gjatë proceseve të konsultimit. Kjo transparencë në ndarjen e rezultateve të konsultimeve nënvizon zotimin e MASHTI-t për t'u angazhuar me palët e interesit dhe për të inkorporuar kontributin e tyre në kornizën legjislative.

Megjithatë, as për këtë vit vlerësues nuk është dhënë përgjigje nëse ekzistojnë mekanizma për ngritjen e shqetësimeve dhe ankesave lidhur me vendimet dhe veprimet e Ministrisë. Si rezultat, mbetet e paqartë nëse ekzistojnë mekanizma të tillë brenda MASHTI-t për të adresuar në mënyrë efektive shqetësimet dhe ankesat e palëve të interesit.

Kjo mungesë e informacionit nënvizon rëndësinë e krijimit të kanaleve të qarta për reagime dhe korigjim të ankesave për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri në aktivitetet e Ministrisë.

Gjatë vlerësimit të qasjes së MASHTI-t në mediat sociale, merren parasysh përditësimet në llogaritë e saj zyrtare të mediave sociale. MASHTI përditëson në mënyrë aktive faqen e saj në Facebook me informacionet më të fundit, duke mbajtur në këtë mënyrë palët e interesit dhe publikun e gjerë të informuar për zhvillimet e fundit. Megjithatë, faqja e MASHTI-t në Twitter aktualisht është joaktive.

Forcimi i përpjekjeve të institucionit për të ofruar përditësime dhe informacione të vazhdueshme për publikun nëpërmjet pranisë aktive në mediat sociale do të rriste qasjen dhe do të përmirësonte ndërgjegjësimin e publikut për funksionimin e institucionit.

NDËRGJEGJSIMI

Komponenti i ndërgjegjesimit të vlerësimit fokusohet në mekanizmat e brendshëm të përdorur nga MASHTI për të monitoruar dhe vlerësuar politikat dhe performancën e tij. Është thelbësore që Ministria të ketë mekanizma të fuqishëm për të vlerësuar performancën e saj institucionale, pasi kjo është thelbësore për monitorim efektiv dhe llogaridhënie. Në vlerësimin më të fundit, MASHTI ka arritur një rezultat të lavdërueshëm prej 81% në këtë komponent, duke treguar një bazë të fuqishme për vlerësimin dhe përmirësimin e brendshëm.

Në kuadër të procedurave të rregullta, MASHTI dorëzon raportin vjetor të punës në Qeverinë e Kosovës. Sipas përgjigjeve të anketës së përfaqësuesve të MASHTI-t, raporti për vitin 2022 është dorëzuar në Qeveri në dhjetor të atij viti. Kjo praktikë e paraqitjes së raporteve gjithëpërfshirëse vjetore është thelbësore për transparencën dhe llogaridhënien, duke mundësuar mbikëqyrje dhe vlerësim efektiv të aktiviteteve të MASHTI-t. Ajo demonstroi përkushtimin e Ministrisë për qeverisje të hapur dhe vullnetin e saj për të qenë transparente në lidhje me performancën dhe arritjet e saj.

Praktikat e raportimit të MASHTI-t, së bashku me ato të ministrive të tjera të linjës në Kosovë, i përmbahen Rregullave dhe Procedurave të Qeverisë së Kosovës, të cilat përcaktojnë formatin dhe përmbajtjen e kërkuar të raporteve të ministrive. Këto raporte i dorëzohen Zyrës së Kryeministrit për miratim, duke siguruar përafrim me standardet dhe politikat e qeverisë. Përveç kësaj, MASHTI, ashtu si ministrinë e tjera, ndjek udhëzimet e përcaktuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit për konsultime publike. Kjo përfshin caktimin e koordinatorëve brenda ministrive të linjës për të lehtësuar konsultimet publike në zhvillimin e legjislacionit dhe politikave.

INTEGRITETI

Për sa i përket parimit të integritetit, i cili përfshin deklarinimin e pasurisë, kodin e mirësjelljes dhe konfliktin e interesit, mund të nxirren disa ide në lidhje me MASHTI-n. Për këtë parim, institucioni në fjalë ka arritur rezultatin prej 65%.

Aktualisht, MASHTI nuk ka kod të mirësjelljes për zyrtarët e saj të publikuar në ueb faqen e saj ose një lidhje me rregulloren për kodin e mirësjelljes së nëpunësve civil të Republikës së Kosovës, e cila gjendet në gazetën zyrtare të vendit.

Kjo mungesë nënvizon domosdoshmërinë që MASHTI të miratojë masa proaktive raportuese etike, duke përfshirë krijimin e protokolleve që përcaktojnë sjelljen e duhur për grupe të ndryshme si liderët e zgjedhur (ministri dhe kabineti i tij), stafi politik dhe nëpunësit publikë.

Në Kosovë, zyrtarët shtetërorë kanë për detyrë të deklarojnë pronën, pasurinë, të ardhurat dhe borxhet e tyre, me informacion të detajuar në dispozicion të deputetëve të Kuvendit. Megjithatë, qasje në detajet e deklarimit të pasurisë kërkon një kërkesë formale në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia Kundër Korrupsionit mbikëqyr menaxhimin e këtyre të dhënave, duke siguruar qasjen e tyre për palët e interesit dhe publikun e gjerë. Gjithashtu, agjencia është përgjegjëse për monitorimin e pasurisë së zyrtarëve publikë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në rast të shkeljeve ligjore.

Për të forcuar më tej masat e integritetit, MASHTI duhet të konsiderojë ofrimin e trajnimeve për zyrtarët e saj për tema që lidhen me aktivitetet e lobimit, konfliktet e interesit, përpjekjet kundër korrupsionit dhe sinjalizimin. Një trajnim i tillë do t'ju ofrojë zyrtarëve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të reaguuar në mënyrë efektive ndaj parregullsive dhe për të mbajtur standarde të larta etike në rolet e tyre, duke kontribuar kështu në integritetin dhe transparencën e përgjithshme të aktiviteteve të MASHTI-it.

Për më tepër, Kosovës aktualisht i mungojnë ligjet që rregullojnë lobistët dhe aktivitetet e tyre, të cilat mund të forcojnë mbrojtjen e interesit publik. Legjislacioni që rregullon lobimin rrit transparencën në sektorin publik dhe rregullon ndërveprimet ndërmjet grupeve të interesit, lobistëve, zyrtarëve publikë dhe politikanëve. Nxjerrja e rregulloreve të qarta për lobim është thelbësore në forcimin e llogaridhënies, forcimin e kornizës ligjore për të luftuar korrupsionin dhe rritjen e efikasitetit të administratës shtetërore.

TRANSPARENCA

MASHTI ka përgjegjësi për avancim të arsimit të lartë, kërkim shkencor dhe nxitje të inovacionit dhe zhvillimit teknik. Për të përmbushur këto përgjegjësi, MASHTI duhet të përpiqet të ruajë një nivel të lartë të transparencës duke publikuar dokumentet dhe informacionet kyçe, duke lehtësuar proceset e konsultimit publik dhe duke mbështetur monitorimin dhe zbatimin e masave të transparencës. Në vlerësimin e këtij parimi, MASHTI ka arritur një rezultat prej 60%.

Transparenca, si parim, kërkon që buxheti, informacioni organizativ dhe metodat e prokurimit të jenë të qasshme për publikun dhe të publikohen në faqen zyrtare të internetit. Faqja e internetit e MASHTI-t demonstroi disa përpjekje drejt transparencës organizative duke përditësuar rregullisht përmbajtjen e saj me njoftime për shtyp nga takime të ndryshme, dokumente zyrtare, raporte dhe strategji.

Për më tepër, faqja e internetit ofron përmbajtje në të dyja gjuhët zyrtare të vendit, duke reflektuar angazhimin për qasje. Informacioni i kontaktit për zyrtarët përgjegjës për komunikimin publik është gjithashtu në dispozicion, duke promovuar angazhimin me palët e interesit. Megjithatë, faqja e internetit nuk përmban informacion të detajuar në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë zyrtare të këtyre zyrtarëve, gjë që mund të pengojë komunikimin efektiv me publikun.

Për më tepër, faqja zyrtare e MASHTI-t nuk zbulon të dhëna për kontratat, raportet buxhetore apo transparencën buxhetore. Informacioni në lidhje me shtrirjen e shërbimeve publike dhe shpenzimet e menaxhimit gjithashtu nuk është i disponueshëm.

Faqja e internetit nuk ofron detaje për procedurat e prokurimit publik, siç janë kërkesat e hapura për oferta, vendimet dhe kontratat për ofertat dhe të dhëna të ngjashme, të cilat janë aspekte të rëndësishme të transparencës në operacionet e qeverisë. Kjo mungesë e zbulimit në këto fusha mund të kufizojë aftësinë e publikut për të kuptuar dhe vlerësuar plotësisht aktivitetet e MASHTI-t dhe përdorimin e burimeve.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E MASHTI SË NË KOSOVË

ODK ka zgjeruar bashkëpunimin me UBO Consulting për të kryer një studim të gjerë mbi perceptimet e qytetarëve dhe angazhimin me MASHTI-n. Ky hulumtim ka përfshirë Intervistimin e 1306 qytetarëve nga sfera të ndryshme, duke siguruar përfaqësim në demografi të ndryshme si mosha, gjinia, përkatësia etnike, vendbanimi dhe të ardhurat familjare. Anketa kishte për qëllim të vlerësonte perspektivat e qytetarëve për reagimin e MASHTI-t ndaj shqetësimeve të tyre dhe aftësinë e tyre të perceptuar për të kontribuar në aktivitetet e saj.

Të gjeturat zbuluan se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë dyshime rreth aftësisë së tyre për të kontribuar në iniciativat e MASHTI-it, ku mbi gjysma e tyre e kanë këtë ndjenjë. Vetëm 33.9% e të anketuarve besojnë se mund të japin një kontribut pozitiv. Anketa vlerësoi gjithashtu kënaqshmërinë e përgjithshme me performancën e MASHTI-t. Ajo nxori në pah se shumica e të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur, me 29.2% që shprehin këtë pikëpamje, ndërsa një përqindje më e vogël, 5.7%, treguan se ishin shumë të kënaqur.

Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e marrjes parasysh të pikëpamjeve të qytetarëve në formësimin e veprimtarisë së MASHTI-t. Rritja e angazhimit të qytetarëve është thelbësore për MASHTI-n pasi nxit një ndjenjë pronësie dhe llogaridhënieje në publik.

Duke përfshirë qytetarët në proceset vendimmarrëse, MASHTI mund të përfitojë nga perspektivat dhe njohuritë e ndryshme, duke çuar në politika më të informuara dhe gjithëpërfshirëse. Për më tepër, angazhimi aktiv i qytetarëve mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit në institucion dhe në rritjen e legjitimitetit të tij, duke kontribuar përfundimisht në qeverisje më efektive dhe rezultate të përmirësuara për komunitetin.

Prandaj, krijimi i kanaleve efektive të komunikimit dhe mundësive domethënëse për pjesëmarrjen e qytetarëve duhet të jetë prioritet për MASHTI-n për të siguruar që politikat dhe iniciativat e saj reflektojnë nevojat dhe aspiratat e njerëzve të cilëve u shërben.

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

Një qasje e qeverisjes së hapur mund të hapë rrugën për metoda inovative të qeverisjes, duke sjellë përfitime si për qeveritë ashtu edhe qytetarët, dhe duke promovuar praktikën e qeverisjes së mirë që përmirësojnë proceset e vendimmarrjes. Bazuar në gjetjet e vlerësimit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit këshillohet të marrë parasysh veprimet e mëposhtme:

- Të inkurajojë në mënyrë aktive pjesëmarrjen e publikut në politikën dhe proceset vendimmarrëse të MASHTI-t, duke njohur kontributet e vlefshme që shoqëria civile, përfshirë OJQ-të dhe sinjalizuesit, mund të japin në vendimmarrje të informuar.
- Publikimi i informacionit të plotë në faqen e internetit të MASHTI-t, duke përfshirë programin vjetor të punës, detajet e personelit (emrat, pozitat, pagat), kontaktet, organogramin, rezymetë e stafit, raportet e punës dhe regjistrat e dokumenteve që disponon. Kjo do të rrisë transparencën dhe do të lehtësojë të kuptuarit e publikut të aktiviteteve të MASHTI-t.
- Të zhvillojë dhe zbatojë një mekanizëm përmes të cilit qytetarët mund të sfidojnë vendimet e marra nga MASHTI, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në proces.
- Të organizojë aktivitete edukative si seminare, punëtori dhe trajnime gjatë shërbimit në kuadër të institucioneve publike për të rritur ndërgjegjësimin për parimet e qeverisjes së hapur dhe rëndësinë e transparencës në qeverisje.
- Publikimi i pagave të zyrtarëve publikë në faqen e MASHTI-t, duke garantuar transparencë në përdorimin e fondeve publike dhe duke nxitur llogaridhënien.
- Të krijojë një formular për ankesa online në faqen zyrtare të MASHTI-t, duke ua mundësuar qytetarëve që të paraqesin ankesa ose kërkesa me detaje përkatëse, duke thjeshtuar procesin për adresimin e shqetësimeve të publikut.
- Të sigurojë që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe qasjet në lidhje me prokurimin publik të publikohen në faqen e internetit të MASHTI-t, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien në aktivitetet e prokurimit.

REKOMANDIMET

- Të shtojë praninë e MASHTI-t në mediat sociale për të komunikuar në mënyrë efektive me një audiencë më të gjerë, për të angazhuar qytetarët në diskutime rreth aktiviteteve të saj dhe për të ofruar përditësime më kohë për iniciativat e saj.
- Publikimi i të gjitha informacioneve dhe dokumenteve në faqen zyrtare të MASHTI-t në formate të hapura (si Microsoft Excel ose Word), duke siguruar qasje dhe përdorshmëri për publikun dhe palët e interesuara.
- Të hartojë dhe publikojë planin e integritetit ose politikës së brendshme kundër korrupsionit që përshkruan masat për të parandaluar korrupsionin dhe sjelljet joetike në kuadër të MASHTI-t, duke përforcuar përkushtimin e institucionit për integritet dhe sjellje etike.

RAPORTE TË TJERA TË NGJAJSHME

RAPORTE TË TJERA

Eksploroni raporte dhe dokumente shtesë të ngjashme me këtë raport të disponueshme në faqen e publikimeve të Open Data Kosovo.

WWW.OPENDATAKOSOVO.ORG/PUBLICATIONS

Nëse keni pyetje shtesë, mos ngurroni të kontaktoni:

info@opendatakosovo.org